

VENDIM
Nr.374, datë 18.5.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E
ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA TE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME TË ISH-SHOQËRISË “LAGUNA E KARAVASTASË”
SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 29 e 33, paragrafi i parë, të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara te Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të pasurive të paluajtshme të ish-shoqërisë “Laguna e Karavastasë” sh.p.k., të identifikuar sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndalohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që t’i tjetërsojë këto prona.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasuritë e shoqërisë “Laguna e Karavastasë” sh.p.k. me sipërfaqe truall 11 792 m² dhe sipërfaqe ndërtese 1216 m², me adresë: Divjakë, Lushnjë, ndarë si më poshtë:

1. Pasuria nr.1396/1, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 540 m² truall);
2. Pasuria nr.1078/3, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 4900 m² + 400 m² ndërtesë);
3. Pasuria nr.1397, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 540 m² truall+ 36 m² ndërtesë);
4. Pasuria nr.1089/6, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 1456 m² + 166 m² ndërtesë + 36 m²);
5. Pasuria nr.1089/9, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 2900 m² truall +(375 m² + 105 m² ndërtesë);
6. Pasuria nr.1089/1, zona kadastrale 1492 (sipërfaqe 1456 m² truall +(42 m² + 28 m² + 74 m² ndërtesë).